



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.844/6 prot.

Datë 08.04.2026

V E N D I M

Nr. 481/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|------------------|------------|
| Fiorent Zguro | Nënkryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar |
| Anila Malaj | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 08.04.2026 shqyrtoi ankesën me :

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “MILIFAR” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-75479-02-06-2026 me objekt: “Shpenzime për D.D.D dhe Pesticide”, me fond limit 4 824 738 (katër million e tetëqind e njëzetë e katër mijë e shatëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 19.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës mbi ankesën e pranuar të operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-75479-02-06-2026 me objekt: “Shpenzime për D.D.D dhe Pesticide”, me fond limit 4 824 738 (katër million e tetëqind e njëzetë e katër mijë e shatëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 19.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK me NIPT M11815028I dhe adresë: Rruga e Kavajës, Buka SH.A, Nr.8240, Njësia Nr.6., Tiranë

Operatori ekonomik “MILIFAR” SHPK me Nipt J8142600II dhe adresë: Rruga “Xhorxhi Martini” Pall Ri 9 kate, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë
Lagjja Kushtrimi, ish Parku i Autobusave, Vlorë

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “MILIFAR” SHPK me Nipt J8142600II dhe adresë: Rruga “Xhorxhi Martini” Pall Ri 9 kate, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se ankesat janë për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj ato duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomik kanë prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomik kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.5. Ankimesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik..

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 09.02.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit: prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-75479-02-06-2026 me objekt: “Shpenzime për D.D.D dhe Pesticide”, me fond limit 4 824 738 (katër million e tetëqind e njëzetë e katër mijë e shatëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë.

II.2. Në datën 09.02.2026 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 27.02.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

| | | |
|--|-----------|------------------|
| 1. “MILIFAR” SHPK | 3,618,550 | lekë kualifikuar |
| 2. “Albania Distribution Chemicals” SHPK | 4,453,300 | lekë kualifikuar |

II.4. Në datën 09.03.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “*Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraparak*” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.5. Me datë 13.03.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2026/6425 datë 13.03.2026 dhe me nr.844 prot., datë 17.03.2026 e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-75479-02-06-2026 me objekt: “Shpenzime për D.D.D dhe Pesticide”, me fond limit 4 824 738 (katër million e tetëqind e njëzetë e katër mijë e shatëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “MILIFAR” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar me pretendimet si më poshtë:

“[...]Ne si OE kemi marrë pjesë në procedurën me objekt prokurimi ‘SHPENZIME PER D.D.D DHE PESTICIDE’ të zhvilluar nga AK ‘Ndermarrja e Sherbimeve Publike Vlore’.

Fondi i kësaj procedure prokurimi ka qene 4.824.738 lek pa tvsh (gjeni bashkangjitur) Në këtë procedure kanë marrë pjesë dy Operator Ekonomik (gjeni bashkangjitur) “Milifar” me vleren 3.618.550 pa tvsh

“Albania Distribution Chemicals” me vleren 4.453.300 pa tvsh

Ne VKM Nr 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit Publik”, Neni 82, Pika 4 është shprehur shumë qarte:

Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Fondi limit I kësaj procedure prokurimi ka qene: 4.824.738, ndersa 25% i kësaj vlere është 1.206.184,5. Duke zbritur vleren e fondit limit me vleren 25% të fondit atehere llogaria del : $4.824.738 - 1.206.184,5 = 3.618.553,5$

Oferta e OE “Milifar” është 3.618.550, dhe automatikisht kjo oferte është dhene 25% poshtë fondit limit, duke cituar edhe Piken 4, të Nenit 82, të VKM 285, në rast kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta në përputhje me nenin 93, të LPP-se oferta vlerësohet anomalisht e ulët. Pra në këtë rast OE “Milifar” duhet të ishte skualifikuar në këtë procedure për shkak të ofertes anomalisht të ulët.

Në përfundim kërkojme:

Skualifikimin e OE “Milifar” duke respektuar dhe të zbatuar, Piken 4, të Nenit 82, të VKM Nr 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit Publik”, gjithashtu në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik, 162/2020, Neni 1, Neni 2, kërkojme të sigurojmë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; të sigurojmë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme: mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; transparencë në procedurat e prokurimit; barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.

Gjithashtu, Neni 27, Ligji Nr 16/2024, ‘Per disa ndryshime të ligjit 160/2020, “Per Prokurimit Publik”, AK, në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, duhet të refuzonte pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”[...].

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurat e prokurimit (objekt,

numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr.844/1 prot., datë 17.03.2026.

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, u konstatua, se në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik është depozituar Formulari i paraqitjes së Argumentave nga operatori ekonomik “MILIFAR” SHPK, protokolluar me tonën nr.844/2, datë 19.03.2026.

II.10. Nëpërmjet shkresës me nr. 198 prot., datë 25.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 844/3 prot., 30.03.2026 me lëndë “Përcjellje vendimi” është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik ankimes nga ku rezulton se autoriteti kontraktor ka pranuar plotësisht ankesën e tij duke argumentuar: [...].

“..... Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave , pas shqyrtimit të ankesës, argumentave të Operatorit Ekonomik “Milifar” dhe gjithë dokumentacionit përkatës

Arsyeton:

Fondi limit i kësaj procedure prokurimi ka qenë: 4, 824,738, ndërsa 25% I kësaj vlere është 1,206,184.5. Duke zbritur vlerën e fondit limit me vlerën 25% të fondit atëherë llogaria del: $4,824,738 - 1,206,184.5 = 3,618,553.5$. Oferta e OE “milifar” është 3,618,550 dhe automatikisht kjo ofertë është nën 25% e fondit limit, duke e klasifikuar si anomalisht e ulët.

Në zbatim të nenit 82, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public”, Ligjit të Prokurimit Publik, 162/2020, Neni1, Neni 2 rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur.

Vendosi

*Pranimin e plotë të ankesës se O.E. Albania Distribution Chemicals
Konstatimin e ofertës së operatorit ekonomik “Milifar” si ofertë anomalisht e ulët...”*

II.11. Në datën 03.04.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6477 si dhe nr. Protokolli 1026/2026 datë 03.04.2026 i operatorit ekonomik “MILIFAR” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-75479-02-06-2026 me objekt: “Shpenzime për D.D.D dhe Pesticide”, me fond limit 4 824 738 (katër million e tetëqind e njëzetë e katër mijë e shatëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 19.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për ankesën e pranuar të paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

II.12. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurat e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr.1026/1 prot., datë 03.04.2026.

II.13. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, u konstatua, se në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik është depozituar Formulari i paraqitjes së Argumentave nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, protokolluar me tonën nr.1026/2, datë 07.04.2026.

III

Komisioni i prokurimit publik

Pas shqyrtimit të mterialeve të fashikullit të shqyrtimit adminsitrativ, në fazën ku ndodhet procedura e hetimit,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK për *Skualifikimin e OE “MILIFAR” SHPK me arsyetimin Oferta e OE “Milifar” eshte 3.618.550, dhe automatikisht kjo oferte eshte dhene 25% poshte fondit limit, duke cituar edhe Piken 4, te Nenit 82, te VKM 285, ne rast kur jane te vleshme dy ose me pak oferta ne perputhje me nenin 93, te LPP-se oferta vleresohet anomalisht e ulet. Pra ne kete rast OE “Milifar” duhet te ishte skualifikuar ne kete procedure per shkak te ofertes anomalisht te ulet*”, Komisioni I Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Nëpërmjet shkresës me nr. 198 prot., datë 25.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 844/3 prot., 30.03.2026 me lëndë “Përcjellje vendimi” është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik ankimues nga ku rezulton se autoriteti kontraktor ka pranuar plotësisht ankesën e tij duke argumentuar: [...].

“..... Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave , pas shqyrtimit të ankesës, argumentave të Operatorit Ekonomik “Milifar” dhe gjithë dokumentacionit përkatës

Arsyeton:

Fondi limit i kësaj procedure prokurimi ka qenë: 4, 824,738, ndërsa 25% I kësaj vlere është 1,206,184.5. Duke zbritur vlerën e fondit limit me vlerën 25% të fondit atëherë llogaria del: 4,824,738 – 1,206,184.5 = 3,618,553.5. Oferta e OE “milifar” është 3,618,550 dhe automatikisht kjo ofertë është nën 25% e fondit limit, duke e klasifikuar si anomalisht e ulët.

Në zbatim të nenit 82, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public”, Ligjit të Prokurimit Publik, 162/2020, Neni 1, Neni 2 rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlogaritur.

Vendosi

*Pranimin e plotë të ankesës së O.E. Albania Distribution Chemicals
Konstatimin e ofertës së operatorit ekonomik “Milifar” si ofertë anomalisht e ulët...”*

III.1.2. Në datën 03.04.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6477 si dhe nr. Protokollin 1026/2026 datë 03.04.2026 i operatorit ekonomik “MILIFAR” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-75479-02-06-2026 me objekt: “Shpenzime për D.D.D dhe Pesticide”, me fond limit 4 824 738 (katër milion e tetëqind e njëzetë e katër mijë e shtatëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 19.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për ankesën e pranuar të paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

III.1.3. Neni 30 i LPP-së i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se : *“1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

Referuar vendimmarrjes së KSHA-së për ankesën e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, lidhur me skualifikimin e operatorit ekonomik “MILIFAR” SHPK, e cila ka vendosur pranimin e plotë të saj, KPP, bazuar në nenin 115, pika 3/b të LPP, do të vijojë shqyrtimin në themel të ankesës së pranuar nga autoriteti kontraktor, për të cilën subjekti i interesuar “MILIFAR” SHPK ka paraqitur argumente dhe më pas ankesë mbi këto argumente.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “MILIFAR” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij, me arsyen se:

“.....Ofertat e paraqitura ne kete procedure prokurimi janë dy dhe ne kete rast oferta konsiderohet anomalisht e ulet nëse eshte ulur me shume se 25 % e fondit limit te përlllogaritur.

Pas llogaritjeve te bëra oferta e shoqërisë tone eshte ne kuotën e vlerës 25% e fondit limit te përlllogaritur (me nje diference te pakonsiderueshme prej 3.5 leke ose =0.0000725 % te cilat janë rrumbullakosjet e bëra nga exeli ne llogaritjen e ofertës sonë te paraqitur ne kete procedure prokurimi dhe nëse i konsiderojmë si gabime aritmetike ato janë me pak se 2%e vlerës ekonomike te ofertës se paraqitur.

Duam te sqarojmë këtu se nuk mund te konsiderohet anomalisht e ulet oferta e shoqërisë tone per nje devijim kaq te vogël dhe te papërfillshëm duke i kursyer buxhetit te shtetit nje shume prej 834750 leke qe eshte diferenca nga operatori ekonomik i dyti.....

..... Sa i takon vendimit te AK qe citon se oferta jone konstatohet anomalisht e ulet, sqarojme se AK nese e ka konstatuar si oferte te tille duhet te kishte marre ne konsiderate te gjitha sqarimet dhe argumentat e bera nga shoqeria jone per kete difference te palogjikshme, rrumbullaksoje te exelit, te pallogaritshme prej vetem 3.5 leke qe se pari eshte absurd e paprecedente dhe pa arsye dhe e pa argumentuar nga AK, dhe se dyti nuk ka arsye pse AK te mos e pranoje kete oferte tone qe eshte shume e sakte dhe shume e argumentuar me fakte, prova e dokumenta qe vërteton me se miri qe kemi paraqitur nje oferte reale dhe me çmime shume te mira dhe per produkte cilesore dhe europiane.

Sipas përcaktimeve te nenit 93 duam te sqarojmë faktin se pse oferta jone eshte paraqitur ne kete vlere, duke garantuar dhe nje cilësi shume te mire te mallrave dhe produkteve te cilat janë kërkuar nga AK per kete procedure prokurimi...”

III.2.1. Në pikën 1 dhe 7 të nenit 34 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se:

1. Llogaritja e vlerës së parashikuar të një prokurimi bazohet në shumën totale që duhet paguar pa TVSH, siç parashikohet nga autoriteti ose enti kontraktor, duke përfshirë çdo pagesë siç përcaktohet qartë në dokumentet e tenderit. Kur autoriteti ose enti kontraktor u jep çmime ose pagesa kandidatëve ose ofertuesve, ai duhet t'i mbajë ato parasysh kur përllogarit vlerën e prokurimit.

7. Kur një punë, mall ose një shërbim mund të rezultojë në dhënien e disa kontratave në formën e loteve të veçanta, duhet të merret parasysh vlere e përgjithshme e të gjitha këtyre loteve.”

III.2.2. Në nenin 93 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj, duke marrë në konsideratë elementet e përmendura në pikën 2 të këtij neni.

Autoritetet ose entet kontraktore e refuzojnë ofertën kur konstatojnë se oferta është anomalisht e ulët, sepse nuk pajtohet me detyrimet e zbatueshme nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës e të akteve të tjera.

4. Nëse një autoritet kontraktor konstaton se një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet të jetë të paktën 3 ditë pune, që ndihma është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët”

III.2.3. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

- Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

- Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

III.2.4. Në Kreun II “Kufijtë monetarë në sektorin klasik” të VKM-së nr.291, datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”, përcaktohet se:

“1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon: a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë; b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon: a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë; b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.”

III.2.5. Referuar pretendimeve në ankesën e paraqitur nga ankimuesit, informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP-së, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve

elektronike konstatohet se, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me objekt “Shpenzime për D.D.D dhe Pesticide” me Nr. REF-75479-02-06-2026, me fond limit: 4 824 738 (katër million e tetëqind e njëzetë e katër mijë e shatëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH zhvilluar në datën 09.02.2026 nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë, kanë ofertuar 2 (dy) operatorë ekonomikë të cilët rezultojnë se përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të vlefshme në respektim të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Mbi bazën e këtij kualifikimi Komisioni ka aplikuar formulën për ofertën/ofertat anomalisht të ulët/ultra mbështetur në përcaktimet ligjore të nenit 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe DST sipas së cilë - në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Referuar këtij përcaktimi 25 % i fondit limit prej 4,824,738 lekë pa tvsh është 3,618,553.5 lekë ndërsa oferta e operatorit ekonomik “MILIFAR” SHPK është në vlerën 3,618,550 lekë. Komisioni gjykon, se sipas përlllogaritjeve të kryera, oferta me vlerë 3,618,550 lekë pa TVSh e operatorit ekonomik “MILIFAR” shpk rezulton të jetë anomalisht e ulët, pasi vlera e saj është ulur më shumë se 25% e fondit limit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “MILIFAR” nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 pika 1, 115 pika 1 dhe 3 si dhe neni 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK për procedurën e prokurimit me “Procedure e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-75479-02-06-2026 me objekt: “Shpenzime për D.D.D dhe Pesticide”, me fond limit 4 824 738 (katër million e tetëqind e njëzetë e katër mijë e shatëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë.

2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “MILIFAR” SHPK për procedurën e prokurimit me “Procedure e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-75479-02-06-2026 me objekt: “Shpenzime për D.D.D dhe Pesticide”, me fond limit 4 824 738 (katër million e tetëqind e njëzetë e katër mijë e shatëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë
3. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit MILIFAR” SHPK, sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijëni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifave financiare të paguara nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.
6. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “MILIFAR” SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

